



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 15 nëntor 2012

Nr. i lëndës 2011-28

Y.

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 15 nëntor 2012, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Znj. Verginia MICHEVA-RUSEVA, anëtare
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është parashtruar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit të datës 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 12 dhjetor 2011. Ankuesi ka kërkuar që mos të paraqitet emri i tij, pasi frikësohej nga pasojat që ai dhe familja e tij mund të kenë nëse identiteti i tij bëhet publik.
2. Më 5 qershor 2012, Paneli ka vendosur ta njoftoj rreth ankesës shefin e misionit (më pas: ShM-në) të EULEX-it në Kosovë, duke ftuar atë që të paraqes vërejtjet e tij me shkrim lidhur me ankesën. Paneli gjithashtu ka vendosur të shqyrtoj meritat e aplikacionit si dhe në të njëjtën kohë edhe të pranueshmërisë së tij (Rregulla 30 §§ 1 dhe 2 e rregullores së punës së Panelit, më tutje: RrP).
3. Vërejtjet e ShM-së janë marrë më 14 shtator 2012. Pastaj ato janë komunikuar tek ankuesi për vërejtje shtesë.
4. Më 4 tetor 2012 ankuesi ka dorëzuar vërejtët e tij shtesë, të cilat i janë përcjellë ShM-së sa për njoftim. Nuk ishin kërkuar vërejtje të tjera.

II. FAKTET

5. Faktet e lëndës siç janë parashtruar nga palët mund të përmbliidhen si në vijim.
6. Ankuesi ka qenë pjesëtar i personelit ndërkombëtar të EULEX-it, i cili nga viti 2002 deri në vitin 2009 ka punuar në Kosovë, ku së pari ishte dërguar në UNMIK dhe pastaj në EULEX.
7. Në vitin 2008, atëherë kur punonte në aeroportin e Prishtinës, ankuesi ka vërejtur se një udhëtar ishte rrëzuar në platformën e aeroportit. Ky person më vonë besohet se kishte dhuruar një organ gjatë një operacioni të jashtëligjshëm të marrjes së organeve.
8. Më pas, ishte ngritur procedurë penale lidhur me akuzat për transplantim të jashtëligjshme të organeve (i ashtuquajtur "rasti Medikus"). Së pari, rasti ishte hetuar nga UNMIK-u, mirëpo më vonë ishte marrë përsipër nga EULEX-i. Një lëndë penale pranë gjykatës së qarkut të Prishtinës lidhur me atë çështje është ende e pazgjidhur.
9. Në një datë që nuk është e saktësuar, ankuesi përmes gruas së tij, e cila po ashtu ishte punëtore e EULEX-it, e ka njoftuar prokurorin kryesues të EULEX-it rreth informatave që i kishte mësuar si rezultat i incidentit që përmendet më lart (shih paragrafin 7) dhe ka ofruar ndihmën e tij në përcaktimin e fakteve të lëndës. Ai i ka ofruar prokurorit të dhënat e veta kontaktuese.
10. Më 14 shkurt 2011 prokurori i EULEX-it ka kontaktuar ankuesin, i cili në ndërkohë ishte kthyer në atdheun e tij dhe e kishte pyetur atë të

jepte një deklaratë si dëshmitar. Ankuesi nuk ka pranuar ta bëjë atë, duke argumentuar se frikësohej për sigurinë e gruas dhe fëmijëve të tij, të cilët ende jetonin në Kosovë. Sidoqoftë, ai premtoj t'i përgjigjej secilës pyetjeje që hetuesit mund të kenë dhe t'i ofroj atyre një raport rreth incidentit ku ai kishte qenë dëshmitar në aeroport në vitin 2008.

11. Më pas, në një datë që nuk është e saktësuar, prokurori i EULEX-it, përgjegjës për lëndën, ka kontaktuar gruan e ankuesit dhe i ka kërkuar asaj të dhënat kontaktuese të ankuesit, të cilat me sa duket ai i kishte humbur. Ankuesi pohon se prokurori gjithashtu ka diskutuar lëndën dhe përfshirjen e tij në të me punëtorë shqiptarë-kosovarë të EULEX-it (me sa duket që nuk kanë qenë të përfshirë në hetim).
12. Pas marrjes së të dhënave për kontakt nga gruaja e ankuesit, prokurori prapë ka kontaktuar atë duke i kërkuar një deklaratë si dëshmitar, mirëpo ankuesi prapë nuk ka pranuar të jep një deklaratë të tillë.
13. Më 12 qershor 2011 një gazetë në atdheun e ankuesit kishte publikuar një artikull rreth "rastit Medikus". Aty ishte përmendur kalimthi se një punëtor i EULEX-it kishte qenë i pranishëm kur viktimat e trafikimit të organeve ishte rrëzuar në aeroport në vitin 2008 (shih paragrafin 8 më lart). As emri, as funksioni e as shtetësia e punëtorit në fjalë nuk ishte dhënë. Asnjë informatë nuk ishte dhënë lidhur me ndonjë mase tjetër të ndërmarrë nga EULEX-i në procedurat vijuese sa i përket përfshirjes së atij punëtori.
14. Më pastaj, prokurori ka kontaktuar ankuesin disa herë duke i kërkuar atij një deklaratë (që ajo deklaratë të merrej qoftë në Kosovë apo në atdheun e ankuesit).
15. Më 7 korrik 2011 ankuesi ishte kontaktuar nga zëvendës shefi i misionit të EULEX-it në Kosovë në disa raste që t'i ofrohej atij dhe familjes së tij masa mbrojtëse. Ankuesi gjithashtu pohon se prokurori po ashtu ishte angazhuar që të ofroj mbrojtje si dëshmitar për të dhe familjen e tij. Pavarësisht kësaj, ankuesi ka vazhduar që mos të pranojë të dëshmojë.
16. Procedurat penale lidhur me "rastin Medikus" kanë filluar në tetor 2011 pranë gjykatës së qarkut të Prishtinës.
17. Ankuesi pohon se më 7 nëntor 2011 ai ishte njoftuar nga zëvendës shefi i misionit se deklarata e tij do të ishte ende e mirëseardhur, mirëpo ai nuk do të detyrohej ta jepte atë.
18. Ankuesi pohon se ai kishte mësuar jo zyrtarisht se emri i tij nuk është në listën e dëshmitarëve në kontekst të procedurave penale të përmendura më lart dhe se nuk ishte bërë ndonjë kërkesë nga autoritetet e ndjekjes që t'i caktohet atij mbrojtja.
19. Ankuesi më tej pohon se si pasojë e këtyre zhvillimeve, shëndeti i gruas së tij ishte përkeqësuar dhe se ajo ishte mjekuar nga depresioni

dhe shqetësimi. Ajo dhe fëmijët e saj ishin larguar nga Kosova dhe ishin bashkuar me ankuesin në atdheun e tij kah fundi i vitit 2011 në mënyrë që asaj t'i ofrohej mjekimi shëndetësor.

III. ANKESAT

20. Ankuesi pohon se ka pasur shkelje të Konventës Evropiane lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore ("Konventa"), veçanërisht shkelje të këtyre dispozitave të Konventës:
- i. Neni 2 (e drejta për jetë)
 - ii. Neni 5 (e drejta për liri dhe siguri)
 - iii. Neni 8 (e drejta për jetë private dhe familjare)
21. Ai kërkon që EULEX-i të mbahet përgjegjës për shkak se nuk është marrë me gjendjen e tij në mënyrë të duhur dhe se nuk ka ofruar siguri për të dhe familjen e tij.
22. Gjithashtu ai kërkon që të zhvillohet një hetim rreth rrjedhjes së dyshuar të informatave, të cilat dyshohet se kanë çuar drejt publikimit të artikullit të gazetës të përmendur më lart (shih paragrafin 13 më lart). Ankuesi pretendon se artikulli ka përmbajtur hollësi që ka mundur të ofrohej vetëm prej brenda EULEX-it dhe që ka bërë të mundur identifikimin e tij dhe të rolit të tij në zbulimin e rastit. Gjithashtu ai pohon se artikulli ka shkaktuar shqetësim të madh tek gruaja e tij, e cila është frikësuar për sigurinë e vet dhe të fëmijëve të vet.

IV. LIGJI

Dokumentet e paraqitura nga palët

23. Në dokumentet e paraqitura prej tij, ShM-ja pohon se nuk ka pasur ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut të ankuesit. Të dhënat personale të ankuesit janë trajtuar me kujdes dhe se akuzat e tij rreth rrjedhjes së informatave janë të pabazuara. Më tej ShM-ja pohon se ankuesi nuk është dëshmitar në "rastin Medikus", prandaj procedurat për mbrojtje të dëshmitarit nuk mund të zbatohen për të.
24. Në përgjigjen e tij ndaj këtyre vërejtjeve, ankuesi përsërit deklaratën e tij fillestare se EULEX-i ka shkelur të drejtat e tij të njeriut. Ai pohon se edhe pse tani për tani ai nuk është në listën e dëshmitarëve, atij i ishte kërkuar që të dëshmoj në gjyq. Megjithatë, nuk ishte kryer ndonjë vlerësim i rrezikut e as nuk ishte siguruar ndonjë mbrojtje për të dhe familjen e tij. Ai pohon se EULEX-i duhej të kishte zhvilluar një

hetim për të përcaktuar nëse kishte pasur rrjedhje të informatave, të cilat më vonë u publikua në artikullin e gazetës në dëm të tij. Më tej ankuesi pohon se trajtimi i pakujdesshëm i situatës nga ana e EULEX-it kishte prishur jetën e tij familjare, kishte shkaktuar probleme shëndetësore tek gruaja e tij dhe kishte bërë që familja e tij të largohej nga Kosova për shkaqe sigurie.

Vlerësimi i Panelit

25. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos se a do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriterin për pranueshmëri të përcaktuar me rregulloren 29 të rregullores së vet të punës.

26. Nuk ka pasur asnjë vërejtje nga palët lidhur me pranueshmërinë e ankesës.

Zbatimi i afatit gjashtë mujor (rregulla 25, paragrafi 3 i rregullores së punës)

27. Paneli së pari konstaton se mund të shqyrtoj vetëm ankesat e parashtruara brenda gjashtë muajve nga data e shkeljes së dyshuar, ashtu siç saktësohet në rregullën 25, paragrafin 3 të rregullores së punës.

28. Paneli konstaton se ankesa përbëhet nga dy aspekte: shkelja e dyshuara e të drejtave të ankuesit si pasojë e zbulimit të informatave të caktuara në një artikull të gazetës, që dyshohet se kanë dalë nga EULEX-i; dhe shkeljet e dyshuara si pasojë e veprimeve të prokurorëve të EULEX-it, për të cilat ankuesi pohon se kanë çuar në rrezikimin e sigurisë së tij dhe të familjes së tij.

29. Për aq sa mund të kuptohet se shkeljet e dyshuara kanë ardhur si rezultat i veprimeve apo mos veprimeve të EULEX-it, i cili ka bërë të mundur publikimin e artikullit të gazetës, Paneli konstaton se ai artikull ishte publikuar më 12 qershor 2011. Lënda ishte parashtruar në Panel më 12 dhjetor 2011.

30. Sa i përket datës *ad quem*, Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut (GjEDNJ-ja) ka gjetur në shumë raste se afati gjashtë mujor brenda së cilës duhet të parashtrohet një ankesë në atë Gjykatë fillon të llogaritet pas datës në të cilën është publikuar vendimi përfundimtar lidhur me atë rast, apo në datën të cilën aplikanti apo përfaqësuesi i tij janë njoftuar për të. Për më tepër, në rrethanat kur nuk ka pasur mjete juridike, ai afat kohor konstatohet që fillon në datën në të cilën ka ndodhur vepra rreth së cilës ka pasur ankesë, apo në datën në të cilën aplikanti ka qenë drejtpërdrejtë i prekur, apo kur është njoftuar për një vepër të fillë apo që kur ka pasur dijeni rreth efekteve të saj negative. Sa i përket kohëzgjatjes së periudhës gjashtëmujore, është

bërë praktikë e vazhdueshme e KEDNj-së për të gjetur se periudha gjashtëmujore kalendarike skadon më vonë, pavarësisht prej kohëzgjatjes së vërtetë të atyre muajve kalendarik (shih *Dennis-i dhe Të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec.), nr. 76573/01, 2 korrik 2002 dhe *Otto kundër Gjermanisë* (dec.), nr. 21425/06, 10 nëntor 2009).

31. Paneli konsideron të përshtatshme që të miratoj qasjen e zhvilluar nga KEDNj-ja si të veten sa i përket pikës fillestare, llogaritjes dhe skadimit të afatit gjashtëmujor për paraqitjen e ankesave në Panel.
32. Prandaj, Paneli gjen se kjo ankesë ishte parashtruar në ditën e fundit të afatit të përcaktuar me rregullën 25 të rregullores së vet të punës. Prandaj, ai ka respektuar afatin gjashtë mujor të përcaktuar nga kjo dispozitë.
33. Lidhur me aspektin e dytë të ankesës (shih paragrafin 28 më lart), vetëm veprimet që i ngarkohen EULEX-it dhe që kanë ndodhur pas datës 12 qershor 2011 hyjnë brenda juridiksionit të Panelit. Gjatë shqyrtimit të kësaj pjese të kësaj ankese, Paneli do të përjashtoj nga shqyrtimi secilin veprim për aq sa thuhet se i ngarkohet EULEX-it dhe që ka ndodhur para datës 13 qershor 2011.

Mandati i Panelit (Rregulla 25, paragrafi 1 i rregullores së punës)

34. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
35. Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve të EULEX-it apo të policisë janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë, prandaj hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit (shih për shembull, *Latif Fanaj kundër EULEX-it*, nr. 2010-06, vendimi i datës 14 shtator 2011).

Shkelja e supozuar e neneve 2 dhe 8 të Konventës

36. Ankuesi pretendon se veprimet dhe mosveprimet e EULEX-it kanë shkelur nenin 2 të Konventës, i cili mbron të drejtën për jetë dhe nenin 8 të saj, i cili garanton të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare. Këto dispozita, për aq sa janë relevante, thonë:

Neni 2:

"1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. (...)"

Neni 8:

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare (...)"

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë shtetërore, sigurisë publike apo mirëqenies

ekonomike të shtetit, për pengimin e prishjes së rendit apo krimin, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

37. Paneli përsërit se fjalia e parë e nenit 2 i kërkon autoriteteve që jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e jashtëligjshme e jetës, mirëpo që gjithashtu të marrin edhe hapat e duhura që të sigurojnë jetët e tyre brenda juridiksionit të vet (në mesin e autoriteteve të tjera shih *L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, paragrafin 36, Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1998-III).
38. Njësoj, synimi kryesor i nenit 8 është që të mbrojë individin ndaj ndërhyrjeve arbitrare që vijnë prej autoriteteve publike. Çfarëdo ndërhyrje sipas paragrafit të parë të nenit 8 duhet të arsyetohet sipas kushteve të paragrafit të dytë se është "në përputhje me ligjin" dhe "e nevojshme në një shoqëri demokratike" për një ose më shumë qëllime legjitime të renditura aty. Sipas praktikës së vendosur gjyqësore të gjykatës, nocioni i domosdoshmërisë nënkupton që ndërhyrja përputhet me një nevojë të ngutshme shoqërore dhe në veçanti është në proporcion me një prej qëllimeve legjitime të ushtruara nga autoritetet (në mesin e autoriteteve të tjera shih *Olsson-i kundër Suedisë* (Nr. 1), 24 mars 1988, § 67, seria A nr. 130). Përveç kësaj, mund të ketë edhe detyrime të tjera pozitive të natyrshme në lidhje me "respektimin" e jetës private. Këto detyrime mund të përfshijnë miratimin e masave të hartuara për të siguruar respektimin e jetës private dhe familjare edhe në fushën e marrëdhënieve midis individëve duke përfshirë zbatimin e masave të caktuara kur është e duhur (në mesin e autoriteteve të tjera shih *X dhe Y kundër Holandës*, 26 mars 1985, § 23, seria A nr. 91).
39. Në rastin në fjalë, në atë masë që ankuesi pretendon se zbulimi i informatave që gjenden në atë artikull e që ka dalë prej veprimeve apo mosveprimeve të EULEX-it, Paneli konstaton se nuk është paraqitur ndonjë dëshmi që tregon se ndonjë informatë që ankuesi i ka ofruar prokurorëve të EULEX-it i ishte dhënë ndonjë pale të tretë duke shkelur të drejtat e tij. As nuk është treguar që ka pasur rrjedhje të informatave lidhur me identitetin e ankuesit e që do t'i ngarkohej EULEX-it. Në secilin rast, Paneli konstaton se artikulli i kontestuar në lidhje me "rastin Medikus" ka përmendur ankuesin dhe ngjarjet e vitit 2008 (shih paragrafin 7 më lart) vetëm në një mënyrë shumë të përgjithësuar. Aty nuk është përfshirë ndonjë e dhënë personale apo e hollësishme që do të lejonte të vërtetohej apo supozohej identiteti i personit, i cili kishte qenë dëshmitar kur personit i kishte rënë të fikët në aeroportin e Prishtinës. Për më tepër, ankuesi nuk ka përmendur ndonjë rrethanë apo fakt që do të lejonte që të pranohej se ndonjë palë e tretë e ka identifikuar atë në bazë të artikullit të kontestuar apo se ai ka marrë ndonjë kërcënim.
40. Prandaj, Paneli nuk mund të pranojë se informatat që gjenden në atë artikull kanë dalë prej EULEX-it dhe përbëjnë shkelje të të drejtave të ankuesit apo se kanë zbuluar mungesën e respektimit të jetës së tij

private apo familjare sipas kuptimit të nenit 8 të Konventës, leje më të drejtën e tij dhe të familjes së tij për jetë, të mbrojtur sipas nenit 2.

41. Për aq sa kjo ankesë ka të bëjë me mos veprimin e dyshuar nga ana e prokurorit të EULEX-it për t'i ofruar siguri ankuesit në lidhje me procedurat penale në vazhdim në "rastin Medikus", së pari Paneli konstaton se në asnjë çast ankuesi nuk ka qenë i detyruar të dëshmoj gjatë procedurave. Refuzimin nga ana e tij për të vepruar ashtu atëherë kur iu ishte kërkuar, ishte respektuar nga ana e EULEX-it. Paneli tashmë ka gjetur se nuk është treguar që identiteti i aplikantit apo vendndodhja e tij ishin zbuluar për publikun (shih paragrafin 39 më lart). Prandaj, Paneli nuk gjen se ankuesi ka vërtetuar që ndonjë veprim apo mosveprim nga ana e autoriteteve të prokurorisë së EULEX-it kanë rrezikuar sigurinë e ankuesit apo të familjes së tij, e leje më që në ndonjë çast jetët e tyre janë vënë në rrezik. Sa i përket pretendimit të ankuesit se shëndeti i gruas së tij kishte pësuar si pasojë e rrethanave rreth të cilave është ankuar dhe që i janë ngarkuar EULEX-it, Paneli konstaton se ai nuk ka paraqitur asnjë dëshmi mjekësore lidhur me gjendjen apo mjekimin e saj.
42. Del se kjo pjesë e ankesës është qartas e pabazuar sipas nenit 29 (d) të rregullores së punës së Panelit.

Shkelja e supozuar e nenit 5 të Konventës

43. Sa i përket asaj që ankuesi mbështetet në nenin 5 të KEDNJ-së, Paneli përsërit se e drejta për "liri dhe siguri të personit" nuk detyron autoritetet që të ofrojnë mbrojtje individuale prej të tjerëve (shih *X kundër Irlandës*, nr. 6040/73, Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut, vendim i datës 20 korrik 1973). Neni 5 i Konventës ka të bëjë me ndërhyrjen arbitrare nga një autoritet publik në lirinë personale të një individi dhe në lirinë e tij apo saj prej arrestimit dhe paraburgimit (shih p.sh. *East African Asians (Aziatikët e Afrikës lindore) kundër MB-së (Mbretërisë së Bashkuar)*, nr. 4626/70 et al., raporti i Komisionit i datës 14 dhjetor 1973, vendimet dhe raportet 78; *X kundër MB-së (Mbretërisë së Bashkuar)*, nr. 5877/72, Komisionit Evropian i të Drejtave të Njeriut, vendimi i datës 12 tetor 1973). Në këtë lëndë nuk është pretenduar apo dëshmuar asnjë ndërhyrje e tillë.
44. Sipas asaj çfarë është përmendur më lart, kjo pjesë e ankesës është gjithashtu e papranueshme, pasi është qartas e pabazuar sipas rregullores 29 (d) të rregullores së punës së Panelit.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

ka gjetur se ankesa është qartas e pabazuar sa i përket rregullës 29 (d) të rregullores së saj të punës, dhe

SHBALL KËTË ANKESË TË PAPANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesuese